

# ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË DEPARTAMENTIT TË AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, PËR VITIN 2024



20 Shkurt 2025

Në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, më datë 20.02.2025 u zhvillua workshop-i “Analiza e punës audituese”, për Departamentin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, për vitin 2024.

Ky workshop pati për qëllim vlerësimin e punës audituese përgjatë vitit 2024. Aktiviteti nisi me fjalën hyrëse të Drejtorit të Departamentit znj. Yllka Pulashi dhe prezantimin e aktivitetit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, rezultatet e auditimit, evidentimin e disa problematika të konstatuara në auditimet e teknologjisë së informacionit, të cilat ndikojnë në performancën e sistemeve, sigurinë e informacionit dhe besueshmërinë e shërbimeve ndaj publikut. Gjithashtu, u prezantuan edhe objektivat e veprimtarisë audituese të departamentit për vitin 2025.

Pjesa tjetër e workshopit vijoi me 3 prezantime mbi aktivitetin e departamentit për vitin 2024 konkretisht:

- znj. Anxhela Kostaj mbi Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në subjektin Ujësjelles Kanalizimet SHA Shkodër,
- znj. Klea Saliu mbi Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Subjektin AKBN/sistemi i lejeve minerare.
- znj. Elira Cukalla mbi bashkëpunimeve me institucionet e huaja dhe homologe, IDI dhe SAI Norvegjez.

Në vijimësi fjalën e mori Sekretari i Përgjithshëm i KLSH-së znj. Valbona Gaxha, e cila në fjalën e saj ndër të tjera theksoj kontributin që audituesit e departamentit duhet të japin jo vetëm në auditimet IT, por edhe në bashkëpunimi me departamente dhe sektorë të tjerë të KLSH-së. Vënien në praktikë të njohurive të përfituara nga trajnimet me homologë të huaj dhe konkretisht nga trajnimet e zhvilluar me SAI-n Norvegjez.

